# DËSHMI ARKIVI

**A-456432**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/teuta-mbreteron-ne-shkoder-vllaznia-zhytet-edhe-me-shume-ne-krize-i104928` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 20:03:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 19:58:52 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6604133dcab6aaddc52a8fcc4ba761fb1bbf43aca0117b82ed72a9f4fa90076a` |
| TEKSTI | `a191d8c71f07169a42bb19f08e73c2f0974c9b7d13f672d8f3a028f11948144b` |
| PAMJA | `64ab407f77cd7b8f9fd7be6f21bcbf8d8b1acb2b00805b04bff8aef377aeddf5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c935e50ffd641ceeef80834f9f928715febf0ea9d202cd4badee4d4d779f477d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f47cbc6d520bd6b958b6f20f356cb94c690d513120412a653d4bc3fd831cb866` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c935e50ffd641ceeef80834f9f928715febf0ea9d202cd4badee4d4d779f477d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Teuta mbretëron në Shkodër, Vllaznia zhytet edhe më shumë në krizë

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 21:58



Durrsakët triumfuan në transfertën e vështirë ndaj shkodranëve, duke konfirmuar momentin e mirë që po kalojnë në këtë fillim sezoni.

Në "Loro Boriçi", Teuta e Edlir Tetovës e nisi ndeshjen me qetësinë e një skuadre që vinte në krye të renditjes, ndërsa Vllaznia kishte mbi supe presionin për të marrë fitoren e parë të sezonit. Pas katër javësh, shkodranët kishin grumbulluar vetëm 2 pikë, ndërsa durrsakët kishin marrë 10 pikë, me tre fitore dhe një barazim.

Teuta arriti të zhbllokojë sfidën në fundin e pjesës së parë. Në minutën e 45-të+2, Boçi u shfaq mirë në krahun e majtë dhe pasoi në qendër, ku Umeijiego devijoi topin dhe e dërgoi në rrjetë, duke i dhënë avantazhin skuadrës durrsake.

Vllaznia u përpoq të reagonte, por përballë kishte një Teutë të organizuar dhe të sigurt në lojën e saj. Durrsakët menaxhuan avantazhin dhe vazhduan të mbajnë nën kontroll një ndeshje që për ta kishte vlerë të dyfishtë: tri pikë në transfertë dhe konfirmim i formës së shkëlqyer me të cilën kanë nisur sezonin.

Për Vllazninë, situata bëhet gjithnjë e më shqetësuese. Pas pesë javësh, shkodranët ende nuk kanë gjetur fitoren e parë në kampionat, ndërsa Teuta vazhdon të jetë një prej skuadrave që kanë dhënë sinjalet më të forta në startin e këtij edicioni.

## Artikuj te sugjeruar


SPORT 18 Shtator20:41

[Granit Xhaka nën hetim nga Prokuroria e Luzernës, ja për çfarë akuzohet mesfushori shqiptar]

Granit Xhaka është përfshirë në një çështje hetimore në Zvicër. Futbollisti shqiptar i Kombëtares s&eum...

SPORT 18 Shtator19:29

[Zidane e nis me revolucion te Franca, tekniku zbulon 23 "Gjelat" e tij të parë për ndeshjet e Nations League]

Zinédine Zidane ka bërë publike listën e tij të parë si trajner i kombëtares së Francës, duke grumbulluar 23 futb...

SPORT 18 Shtator17:19

[Yamal nuk kursehet, sulmon Kane dhe Mbappe: Topi i Artë është për më të mirin, jo për golashënuesin dhe fituesin e Championsit]

Lamine Yamal ka ndezur sërish garën për Topin e Artë me një deklaratë që po interpretohet si një thumbim ndaj Harry Kane...

SPORT 18 Shtator15:57

**Franca nis epokën Zidane/ Trajneri vendos rregulla të reja për marrëdhënien me mediat**

Zinedine Zidane ka nisur zyrtarisht detyrën si trajner i Kombëtares së Francës, duke sjellë ndryshime të dukshme në më...

SPORT 18 Shtator15:41

**E papritur në merkato/ Arbër Hoxha largohet nga Dinamo Zagreb dhe transferohet në Emiratet e Bashkuara Arabe**

Sulmuesi anësor i Kombëtares shqiptare, Arbër Hoxha, pritet të largohet nga Dinamo Zagreb për t'iu bashkuar klubit Al Wahda n&e...

SPORT 18 Shtator15:34

**Ronaldo grumbullohet sërish pas Botërorit, CR7 do të luajë ndeshjet e radhës me Portugalinë në Ligën e Kombeve**

Jorge Jesus ka publikuar listën e tij të parë si trajner i Portugalisë dhe në të është edhe Cristiano Ronaldo. Trajneri ...

SPORT 18 Shtator15:27

**Roma-Inter/ Gasperini ul entuziazmin para supersfidës: Ata janë skuadra më e fortë në Serie A, shifrat e tregojnë superioritetin**

Roma dhe Interi përballen në një prej sfidave më të rëndësishme të këtij faze të kampionatit, me të dyj...

SPORT 18 Shtator15:21

**Del lista e Kosovës, mes të grumbulluarve edhe talenti i Bayern**

Kosova do të përballet në Nations League me Irlandën, Austrinë dhe Izraelin. Pak më parë, tekniku i dardanëve, Franco ...

SPORT 18 Shtator14:46

**"E meritoj Topin e Artë", Lamine Yamal shpall veten favorit...**

Ndryshe nga Harry Kane, Lamine Yamal është totalisht i bindur kur pyetet në lidhje me favoritin për "Topin e Artë". N&eu...

SPORT 18 Shtator14:41

**Foda reagon pas çështjes Rrahmani: Ka shumë dramë, po ekzagjerohet …**

Trajneri i Kosovës, Franco Foda, ka konfirmuar se kapiteni Amir Rrahmani e ka njoftuar personalisht për vendimin e tij për t'u tërhe...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

**"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...**

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 17 Shtator

**Tmerri i incestit/ Nëna 46-vjeçare pranon se ka...**

Një nënë e martuar dhe djali i saj janë akuzuar për incest, pasi ajo pranoi se të dy kishin kryer marrëdhënie seksuale &...

BOTA 18 Shtator

**Trump: Ka pasur përparim të madh drejt bazës us...**

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, deklaroi të enjten se ka pasur "përparim të madh" drejt krijimit të një baze ush...

INVESTIGIME 18 Shtator21:39

**TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të "Tigrave"**

Dy TEC-et lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3", të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qenë...

## video






**TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”**





**TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të "Tigrave"**




**Liria nuk burgoset, as në Hagë, as në Beograd**




**"Ministrja kopjace"/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.